

**GJYKATA THEMELORE E PEJËS**

**P. nr. 38/12**

**Dt. 23 janar 2013**

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore e Pejës, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki, si Kryetar i trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons dhe Gjyqtari i Kosovës Shaban Shala, si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga proces-mbajtësja Nexhmije Mezini, në lëndën penale kundër të akuzuarve:

1. **B.N.** emri i babait xxx, lindur më xxx në xxx, banues në xxx, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri më 01 qershor 2012 kur u lirua me dorëzani,
2. **N.B.** emri i babait xxx, lindur më xxx, banues në xxx banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri më 01 qershor 2012 kur u lirua me dorëzani,
3. **B.B.** emri i babait xxx, lindur më xxx në xxx, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e

arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri më 01 qershor 2012 kur u lirua me dorëzani,

4. **A.B.** emri i babait xxx, lindur më xxx, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 13 qershor 2011 deri më 29 maj 2012 kur u lirua me arrest shtëpiak që u ndërpre më 20 nëntor 2012,

5. **A.B.** emri i babait xxx, banues në xxx, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 11 qershor 2011 deri më 29 maj 2012 kur u lirua me arrest shtëpiak që u ndërpre më 20 nëntor 2012,

6. **M.B.** emri i babait xxx, lindur më xxx në xxx, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 11 qershor 2011 deri më 31 maj 2012 kur u lirua me dorëzani,

7. **S.B.** emri i babait xxx, lindur më xxx në xxx, banor i Republikës së Kosovës, në paraburgim që nga data e arrestimit të tij më 10 qershor 2011 deri më 29 maj 2012 kur u lirua me arrest shtëpiak që u ndërpre më 20 nëntor 2012,

8. **A.P.** emri i babait xxx, lindur më xxx në xxx, banor i Republikës së Kosovës

9. **Z.Z.** nofka "Z", emri i babait xxx, lindur më xxx në, banor i Republikës së Kosovës

të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (SPRK), PPS. nr. 11/11, datë 28 tetor 2011, me këto vepra:

se në një datë të papërcaktuar deri më 10 qershor 2011, duke vepruar si një grup i strukturuar, me qëllimin për të siguruar përfitim pasuror dhe duke rrezikuar jetën dhe sigurinë e migrantëve, ata kontrabanduan shtetas të Republikës së Kosovës, në mënyrë të tillë që ata gjenin migrantë të interesuar për të shkuar në vende të ndryshme europiane, ranë dakord me një çmim që duhej të paguanin migrantët, çmim që arrinte në shumën 1500 euro deri në 3000 euro për person, dhe pastaj të njëjtët migrantë dërgoheshin në mënyrë të paligjshme, përmes njerëzve të ndryshëm, në Serbi, disa prej të cilëve përmes Serbisë dhe Hungarisë dhe disa përmes Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë, për në vende të ndryshme europiane, ndër të cilët migrantë ishin E.I., B.Th., S.B, F.F, I.V. A.K., A.M., I.H., I.P., L.C., B.A., A.Th., P.V., Z.H., S.V., B.V., M.H. si dhe migrantë të tjerë të paidentifikuar,

veprime të tilla u klasifikuan si këto vepra penale:

- Krim i organizuar, nga neni 274 paragrafi 2 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse ata kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në veprimtari kriminale ose veprimtari të tjera të një grupi të organizuar kriminal, me dijeninë se pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte në kryerjen e veprave të rënda nga grupi i organizuar kriminal;

- Kontrabandimi me migrantë, nga neni 138 paragrafi 6, lidhur me nenin 23 të KPK-së, pasi vepra penale u krye në mënyrë të tillë që vuri në rrezik jetën dhe sigurinë e migrantëve,

pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit gjyqësor më 10, 23, 24, 29 dhe 31 maj 2012, 24 dhe 25 korrik 2012, 6, 8, 14, 15 dhe 20 nëntor 2012 dhe më 22 dhe 23 janar 2013 në prani të:

- të akuzuarit B.N. dhe mbrojtësit të tij G.K.,
  - të akuzuarit N.B. dhe mbrojtëses së tij L.H.,
  - të akuzuarit B.B dhe mbrojtësit të tij Xh.R.,
  - të akuzuarit A.B.dhe mbrojtësit të tij F.K.,
  - të akuzuarit A.B. dhe mbrojtësit të tij I.H.
  - të akuzuarit M.B. dhe mbrojtësit të tij B.T.,
  - të akuzuarit S.B. dhe mbrojtësit të tij M.H.,
  - të akuzuarit A.P.dhe mbrojtësve të tij B.E.dhe S.Z.
  - të akuzuarit Z.Z. dhe mbrojtësit të tij z. E.A.,
- pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues, të mbajtur më 23 janar 2013, bazuar në nenin 391 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të 6 nëntorit 2008 (KPPK);

më 23 janar 2013, në bazë të nenit 392 paragrafi 1 të KPPK-së, shqipton në publik, këtë

## **A K T G J Y K I M**

### **I. B.N.** është fajtor sepse:

ndërmjet 01 qershorit 2011 dhe 10 qershorit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 1800 eurosh, ai kontrabandoi B.Th., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Austrisë, duke organizuar transportimin e tij me autobus dhe duke mundësuar në mënyrë të papërcaktuar hyrjen e tij në Zonën Schengen, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme, përmes kufirit ndërmjet Serbisë dhe Zonës Schengen,

me të cilin veprim B.N. kreu veprën penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të 20 prillit 2012 (KPRK);

prandaj, ai

### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së, me 2 (dy) vjet burgim dhe me gjobë në shumën 3000 (tre mijë) euro.

### **II. N.B.** është fajtor sepse:

1. midis 1 janarit 2011 dhe prillit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin

për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 5400 eurosh, kontrabandoi P.V., B.V. dhe Z.H., shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk ishin banorë të përhershëm ose shtetas të ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Hungarisë, duke organizuar transportimin e tyre me autobus për në Republikën e Serbisë, nga ku ata shkuan në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen;

2. në prill 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 2200 eurosh, ai kontrabandoi S.V., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Austrisë, duke organizuar transportimin e tij me autobus për në Serbi, nga ku ai shkoi në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen, dhe pastaj u transportua me kamion për në territorin e Republikës së Austrisë;

3. më 10 qershor 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 4000 eurosh, ai tentoi të kontrabandonte S.B. dhe F.F., shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk ishin

banorë të përhershëm ose shtetas të ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Austrisë, duke e pajisur S.B. me pasaportën e rregullt nr. xxx të H.K., të lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, të ndryshuar nga një person i paidentifikuar, duke zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografinë e S.B., dhe duke e pajisur F.F. me pasaportën e rregullt nr. xxx të B.Th., të lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, të ndryshuar nga M.B. duke zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografinë e F.F., dhe duke organizuar transportimin e S.B. dhe F.F. me autobus për në Republikën e Serbisë, nga ku ata supozohej të shkonin në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen dhe pastaj për t'u transportuar për në territorin e Republikës së Austrisë, gjë që nuk u arrit sepse S.B. dhe F.F. u ndaluan nga Policia e Kosovës ndërkohë që po kalonin kufirin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,

me të cilin veprim N.B. kreu në vazhdimësi siç përkufizohet në nenin 81 i KPRK-së:

- veprën penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së, në lidhje me veprat penale të përshkruara në II.1 dhe II.2;

- veprën penale të tentativës së kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së dhe nenit 28 paragrafët 1 dhe 2 të KPRK-së, në lidhje me veprën penale të përshkruar në II.3,

prandaj, ai

### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 81 paragrafi 1 të KPRK-së, për veprat penale të përshkruara në II.1, II.2, dhe II.3, me 4 (katër) vjet burgim dhe me gjobë në shumën 10 000 (dhjetë mijë) euro.

III. **B.B** është fajtor sepse:

1. në prill 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 1800 eurosh, në bashkëpunim me A.B., ai kontrabandoi A.M, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Austrisë, duke organizuar transportimin e tij me autobus për në Republikën e Serbisë, nga ku ai shkoi në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen,
2. në mars 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 1650 eurosh dhe me ndihmën e Z.Z., i cili i pagoi shumën e lart-përmendur të parave, kontrabandoi në mënyrë të papërcaktuar E.I., shtetas i



Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i Konfederatës Zvicerane nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Konfederatës Zvicerane, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në këtë vend,

me të cilin veprim B.B kreu në vazhdimësi, siç përkufizohet në nenin 81 të KPRK-së, veprën penale të:

- bashkë-ekzekutimit në kontrabandimin me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 31 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të përshkruar në III.1;
- kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të përshkruar në III.2;

prandaj, ai

#### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 81 paragrafi 1 të KPRK-së, për veprat penale të përshkruara në III.1 dhe III.2, me 3 (tre) vjet burgim dhe gjobë në shumën 4000 (katër mijë) euro.

IV. **A.B.** është fajtor sepse:

1. në prill 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 1800 eurosh, në bashkëpunim me B.B, ai kontrabandoi A.M., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë

shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Austrisë, duke organizuar transportimin e tij me autobus për në Serbi, nga ku ai shkoi në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen,

me këtë veprim A.B. kreu veprën penale të:

- bashkë-ekzekutimit në kontrabandimin me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 31 të KPRK-së.

2. Në shtator 2010, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 1100 eurosh, e pajisi M.H., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte shtetas ose banor i Zvicrës, me dokument udhëtimi të rremë, duke ditur se M.H. kishte për qëllim ta përdorte atë për hyrje në Turqi dhe më pas në Zvicër, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në këto shtete, ndërsa i përmenduri M.H. e përdori dokumentin për atë qëllim,

Me këtë veprim A.B. kreu veprën penale të:

- kontrabandimit me migrantë duke siguruar dokumente udhëtimi të rreme, në shkelje të nenit 170 paragrafi 2 të KPRK-së.

prandaj, ai

**dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së, për veprën penale të përshkruar nën IV.1, me 2 (dy) vjet burgim dhe me gjobë në shumën 3000 (tre mijë) euro;

në bazë të nenit 170 paragrafi 2 të KPRK-së, për veprën penale të përshkruar nën IV.2, me 1 (një) vit burgim dhe me gjobë në shumën 2000 (dy mijë) euro;

dhe në bazë të nenit 80 paragrafi 2 nën-paragrafët 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, për të dyja veprat e mësipërme A.B. dënohet me dënimin unik prej 2 (dy) vjetësh dhe 6 (gjashtë) muajsh burgim, dhe dënimin unik me gjobë në shumën 4000 (katër mijë) euro.

V. **A.B.** është fajtor sepse:

1. në shtator 2010, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 2200 eurosh, dhe me ndihmën e A.P., i cili e kishte kontaktuar me I.P. dhe i cili i kishte paguar shumën e përmendur të parave, ai kontrabandoi I.P., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Serbisë dhe pastaj për në territorin e Austrisë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen;
2. ndërmjet 15 marsit 2011 dhe 15 prillit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 2200

eurosh dhe me ndihmën e A.P., i cili e kishte kontaktuar me L.C., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, ai kontrabandoi L.C. nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Serbisë, nga ku ai shkoi në këmbë në Hungari dhe pastaj në mënyrë të paditur për në territorin e Austrisë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen,

me këtë veprim A.B. kreu në vazhdimësi, siç përkufizohet në nenin 81 të KPRK-së:

- veprën penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së;

prandaj, ai

### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 81 paragrafi 1 të KPRK-së, për veprat penale të përkthura në V.1 dhe V.2 me 3 (tre) vjet burgim dhe me gjobë në shumën 4000 (katër mijë) euro.

VI. **M.B.** është fajtor sepse:

ndërmjet 1 majit 2011 dhe 10 qershorit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, ai ndryshoi një dokument publik, domethënë pasaportën e rregullt nr. xxx të B.Th., të lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, duke zëvendësuar me përdorimin e pincetave fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografinë e F.F., me qëllimin që

ky dokument të përdorej si i rregullt për të kaluar kufirin e Kosovës;

me këtë veprim M.B. kreu veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, në shkelje të nenit 332 paragrafi 3 të KPK-së;

prandaj, ai

### **dënohet**

në bazë të nenit 332 paragrafi 3 të KPK-së, me 1 (një) vit burgim dhe në bazë të nenit 54 paragrafët 1 dhe 2, nën-paragrafi 1, të KPK-së, me gjobë në shumën 1000 (një mijë) euro.

VII. **S.B.** është fajtor sepse:

1. në vitin 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 3600 eurosh, kontrabandoi B.A. dhe një mashkull tjetër të paidentifikuar, shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk ishin banorë të përhershëm ose shtetas të ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Zonës Schengen, duke organizuar transportimin e tyre me autobus për në Republikën e Serbisë, nga ku ata shkuan në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen;
2. ndërmjet 1 janarit 2011 dhe 9 qershorit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllimin për të siguruar për veten e tij përfitimin pasuror prej 1600

eurosh, ai kontrabandoi një mashkull të paidentifikuar të quajtur F. nga fshati xxx, i cili ishte shtetas i Republikës së Kosovës dhe nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Zonës Schengen, duke organizuar transportimin e tij me autobus për në Republikën e Serbisë, nga ku ai shkoi në këmbë përmes kufirit me Hungarinë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen;

me këtë veprim S.B. kreu në vazhdimësi, siç përkufizohet në nenin 81 të KPRK-së:

- veprën penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së;

prandaj, ai

#### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1, nenit 75 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, dhe nenit 76 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, dhe nenit 81 paragrafi 1 për veprat penale të përshkruara në VII.1 dhe VII.2 me 1(një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë në shumën 500 (pesëqind) euro.

VIII. **A.P.** është fajtor sepse:

1. në shtator 2010, në territorin e Republikës së Kosovës, ai i dha ndihmë A.B., i cili veproi me qëllimin për të siguruar për veten e tij një përfitim

prej 2200 eurosh, duke e kontaktuar A.B. me I.P., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, dhe duke i premtuar A.P. se do ta paguante dhe duke e paguar atë më pas në shumën 2200 euro për kontrabandimin nga ana e tij të I.P. nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Serbisë dhe nga atje për në territorin e Republikës së Austrisë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen;

2. ndërmjet 15 marsit 2011 dhe 15 prillit 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, ai i dha ndihmë A.B., i cili veproi me qëllimin për të siguruar për veten e tij një përfitim prej 2200 eurosh, duke e kontaktuar A.B. me L.C., shtetas i Republikës së Kosovës, i cili dëshironte të emigronte në mënyrë të paligjshme nga Republika e Kosovës, ndërsa A.B. kontrabandoi L.C., i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Austrisë, duke organizuar transportimin e tij me autobus nga Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Serbisë, nga ku ai shkoi në këmbë për në Hungari dhe pastaj në mënyrë të paditur për në territorin e Republikës së Austrisë, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në Zonën Schengen.

me këtë veprim A.P. kreu në vazhdimësi, siç përkufizohet në nenin 81 të KPRK-së:

- veprën penale të ndihmës në kontrabandimin me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 33 paragrafi 2 të KPRK-së;

prandaj, ai

### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1, nenit 75 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, dhe nenit 76 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, nenit 33 paragrafi 1, dhe nenit 81 paragrafi 1 të KPRK-së, për veprat penale të përshkruara në VIII.1 dhe VIII.2 me 10 (dhjetë) muaj burgim dhe me gjobë në shumën 500 (pesë qind) euro;

në bazë të nenit 51 paragrafi 2 dhe nenit 52 paragrafi 2 të KPRK-së, dënimi me burgim i caktuar kundër A.P. nuk do të ekzekutohet në rast se A.P. nuk kryen veprë tjetër penale gjatë kohës së verifikimit prej 2 (dy) vjetësh.

IX. **Z.Z.** është fajtor sepse:

në mars 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, ai i dha ndihmë B.B, i cili veproi me qëllimin për të siguruar për veten përfitimin pasuror prej 1650 eurosh, duke i premtuar se do ta paguante dhe më pas duke e paguar në shumën 1650 euro për kontrabandimin nga ana e tij të E.I., shtetas i Republikës së Kosovës i cili nuk ishte banor i përhershëm ose shtetas i Konfederatës Zvicerane, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Konfederatës Zvicerane, pa zbatuar rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në atë vend.



me këtë veprim Z.Z. kreu veprën penale të ndihmës në kontrabandimin me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 dhe nenit 33 të KPRK-së;

prandaj, ai

### **dënohet**

në bazë të nenit 170 paragrafi 1, nenit 75 paragrafi 1, nën-paragrafi 1, dhe nenit 76 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, dhe nenit 81 paragrafi 1 të KPRK-së, për veprën penale të përshkruar në IX më lart me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë në shumën 300 (treqind) euro;

në bazë të nenit 51 paragrafi 2 dhe nenit 52 paragrafi 2 të KPRK-së, dënimi me burgim i caktuar kundër Z.Z. nuk do të ekzekutohet në rast se Z.Z. nuk kryen vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit prej 1 (një) viti.

X. Në bazë të nenit 46 paragrafi 2 të KPRK-së, afati për pagimin e gjobave nga të akuzuarit **B.N., N.B., B.B, A.B., A.B., S.B., A.P.** dhe **Z.Z. vendoset në afatin 3 (tre) muaj.**

XI. Në bazë të nenit 39 paragrafi 2 të KPRK-së afati për pagimin e gjobave nga të akuzuarit **M.B. vendoset në afatin 3 (tre) muaj.**

XII. Të akuzuarit **B.N., N.B., B.B, A.B., A.B., M.B., S.B., A.P.** dhe **Z.Z.**

### **lirohen nga akuza**

se kanë kryer krim të organizuar, nga neni 274 paragrafi 2,

lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sepse ata nuk kanë marrë pjesë aktivisht në veprimtari kriminale ose veprimtari të tjera të një grupi të organizuar kriminal, me dijeninë se pjesëmarrja e tyre do të kontribuont në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi i organizuar kriminal.

XIII. Në bazë të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-së, periudhat e heqjes së lirisë së të pandehurve do të llogariten ne afatin e dënimit me burgim të caktuar kundër tyre, përkatësisht:

- për B.N., nga 10 qershori 2011 deri më 01 qershor 2012,
- për N.B., nga 10 qershori 2011 deri më 01 qershor 2012
- për B.B, nga 10 qershori 2011 deri më 01 qershor 2012
- për A.B., nga 13 qershori 2011 deri më 20 nëntor 2012,
- për A.B., nga 11 qershori 2011 deri më 20 nëntor 2012,
- për S.B., nga 10 qershori 2011 deri më 20 nëntor 2012.

XIV. Në bazë të nenit 83 paragrafi 1 të KPK-së, periudha e heqjes së lirisë ndaj të pandehurit M.B., nga 11 qershori 2011 deri në 31 maj 2012, do të llogaritet ne afatin e dënimit me burgim të caktuar kundër tij.

XV. Në bazë të nenit 54 paragrafët 1 dhe 3, nën-paragrafi 7, dhe nenit 60 paragrafi 1 të KPK-së, kundër të

pandehurit M.B. caktohet dënimi plotësues i konfiskimit të pincetave të përdorura në kryerjen e veprës penale dhe tani në zotërim të Policisë së Kosovës, Departamenti i Krimit të Organizuar për Rajonin e Prishtinës.

XVI. Në bazë të nenit 102 paragrafi 1, lidhur me nenin 99 paragrafi 2, nën-paragrafi 6, të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale do të mbulohen pjesërisht nga të akuzuarit si vijon:

- nga B.N., në shumën paushall prej 150 (një qind e pesëdhjetë) eurosh,
- nga N.B., në shumën paushall prej 300 (treqind) eurosh,
- nga B.B, në shumën paushall prej 200 (dyqind) eurosh,
- nga A.B., në shumën paushall prej 200 (dyqind) eurosh,
- nga A.B., në shumën paushall prej 200 (dyqind) eurosh,
- nga M.B., në shumën paushall prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) eurosh,
- nga S.B., në shumën paushall prej 200 (dyqind) eurosh,
- nga A.P., në shumën paushall prej 30 (tridhjetë) eurosh,

- nga Z.Z., në shumën paushall prej 30 (tridhjetë) eurosh.

Pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës penale do të paguhet nga buxheti i gjykatës, në bazë të nenit 102 paragrafi 2 të KPPK-së.

## **A R S Y E T I M**

### **Ecuria procedurale**

#### **Aktakuza**

Më 28 tetor 2011, Prokuroria Speciale ngriti aktakuzën PPS. nr. 11/11 kundër të gjithë të akuzuarve të përmendur më lart, për veprat penale të krimit të organizuar, në shkelje të nenit 274 paragrafi 2, lidhur me nenin 23, të KPK-së, dhe kontrabandimit me migrantë, me pretendimin se ato u kryen në mënyrë të tillë që rrezikuan jetën dhe sigurinë e migrantëve, në shkelje të nenit 138 paragrafi 6, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Sipas aktakuzës, veprat penale në fjalë u kryen në periudhën midis një date të papërcaktuar dhe 10 qershorit të vitit 2011, në vende të ndryshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Më 24 janar 2012, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës i Gjykatës së Qarkut në Pejë, e konfirmoi aktakuzën e lartpërmendur përmes aktvendimit KA. nr. 426/11.

Gjatë seancës për konfirmim e aktakuzës dhe në shqyrtimin gjyqësor, të gjithë të akuzuarit u vetë-deklaruan jo fajtorë.

### **Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues**

Të akuzuarit u akuzuan, ndër të tjera, me një veprë të krimit të organizuar, e dënueshme me burgim nga një deri në dymbëdhjetë vjet. Kjo përcaktoi kompetencën lëndore të gjykatës së qarkut, sepse në bazë të nenit 23 (1) të KPPK-së, kompetenca për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet i përkiste ekskluzivisht kësaj gjykate.

Sipas Aktakuzës, veprat penale me të cilat akuzoheshin të akuzuarit, pretendohet se kanë ndodhur në Kosovë. Megjithatë, siç paraqitet në përshkrimin e detajuar të veprimeve kriminale të ndërmarra nga disa prej të akuzuarve, në raste të shumta të akuzuarit pretendohet se vepronin në Pejë. Prandaj, në bazë të nenit 27 (1) të KPPK-së, kjo gjykatë ka juridiksion territorial për të gjykuar lëndën.

Asnjë çështje nuk u ngrit nga palët në lidhje me juridiksionin e kësaj gjykate.

Sipas nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 korrik 2010, nga 1 janari 2013 Gjykata e Qarkut në Pejë u shndërrua në Gjykatën Themelore të Pejës, pa ndonjë ndryshim në juridiksionet territorial ose lëndor të saj, që

do të ishte në ndonjë mënyrë përkatëse për procedurën në këtë lëndë.

### **Shqyrtimi gjyqësor**

Shqyrtimi gjyqësor u mbajt në publik më 10, 23, 24, 29 dhe 31 maj 2012, 24 dhe 25 korrik 2012, 6, 8, 14, 15 dhe 20 nëntor 2012 dhe më 22 dhe 23 janar 2013, në prani të prokurorit special Besim Kelmendi, në prani të të akuzuarit B.N. dhe mbrojtësit të tij G.K., të akuzuarit N.B. dhe mbrojtëses së tij L.H., të akuzuarit B.B dhe mbrojtësit të tij Xh.R., të akuzuarit A.B. dhe mbrojtësit të tij F.K., të akuzuarit A.B. dhe mbrojtësit të tij I.H., të akuzuarit M.B. dhe mbrojtësit të tij z. B.T., të akuzuarit S.B. dhe mbrojtësit të tij z. M.H., të akuzuarit A.P. dhe mbrojtësve të tij B.E. dhe S.Z., të akuzuarit Z.Z. dhe mbrojtësit të tij z. E.A.

Duhet theksuar se periudha kohore e shtyrjes së seancave ndërmjet seancave të mbajtura më 24 korrik 2012 dhe pastaj më 20 nëntor 2012, e tejkaloi periudhën prej 3 muajsh të parashikuar në nenin 345 paragrafi 3 të KPPK-së. Megjithatë, trupi gjykues mbeti i njëjtë dhe pas kërkesave të të gjitha palëve, trupi gjykues vendosi që të vazhdojë me dëgjimin e dëshmive dhe provave.

Asnjë prej të dëmtuarve ose përfaqësuesve të tyre nuk morën pjesë në gjykim. Aktakuza tregonte personat e mëposhtëm si të dëmtuar: E.I., B.Th., S.B, F.F., I.V., A.K., A.M., I.H. I.P., L.C., B.A., A.Th., P.V., Z.H., S.V., B.V., M.H.. Sipas informacionit të siguruar nga trupi gjykues, vetëm F.F., S.B. dhe E.I. mendohej të ishin të pranishëm në

Kosovë, kur filloi shqyrtimi gjyqësor. Vendet e banimit të të gjithë të dëmtuarve të tjerë mbetën të panjohura, çka e bëri të pamundur që ata të thirren për në shqyrtim gjyqësor. Gjatë seancës së konfirmimit të aktakuzës, E.I. hoqi dorë nga të drejtat e tij si palë e dëmtuar. F.F. u paraqit në gjykatë për shqyrtimin gjyqësor pasi ishte thirrur edhe si dëshmitar, por ai zgjodhi të mos marrë pjesë si palë në procedurë. S.B. nuk u paraqit, sepse thirrja nuk ka mund t'i dorëzohet, për shkak se vendi i tij i tanishëm i banimit mbeti i panjohur. Z. G.K., mbrojtësi për B.N., kërkoi që E.I. të mos konsiderohej palë e dëmtuar. Në fjalën e tij përfundimtare, Prokurori kishte rënë pjesërisht dakord me këtë kërkesë, sepse ai e ndryshoi aktakuzën duke hequr nga dispozitivi i saj emrat e E.I. dhe I.V.. Sipas nenit 386 të KPPK-së, gjykata nuk ishte e detyruar t'i përmbahej kësaj marrëveshjeje lidhur me ndryshimin e akuzave.

Në bazë të nenit 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë përkthyen dokumentet e procedurës gjyqësore, si dhe të gjitha dokumentet gjyqësore të nevojshme për shqyrtimin gjyqësor nga anglishtja në shqipe dhe anasjelltas, sipas rastit.

Më 1 janar 2013 hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, për këtë arsye trupi gjykues duhej të vendoste lidhur me procedurën e zbatueshme. Sipas nenit 545 paragrafi 1 të Kodit të ri, përcaktimi nëse të përdoret kodi i ri i procedurës penale, duhet të bazohet në datën e ngritjes së aktakuzës. Veprat që kanë ndodhur para hyrjes së fuqi të këtij Kodi, do të jenë objekt i këtij Kodi, nëse procedura penale për hetimin dhe ndjekjen e atij akti është iniciuar

pas 1 janarit 2013. Prandaj, trupi gjykues arriti në përfundimin se, për të përfunduar shqyrtimin gjyqësor, dispozitat e KPPK-së duhet të jenë ende të zbatueshme.

### **Përmbledhja dhe vlerësimi i provave të paraqitura**

Trupi gjykues shqyrtoi me kujdes dhe vlerësoi deklaratat e mëposhtme:

dëshmia e të dëmtuarit F.F., e dhënë në gjykatë më 10 maj 2012, dëshmitë e D.V., N.A., S.B. dhe Gj.L., të dhëna më 31 maj 2012, dëshmitë e S.M., S.O., E.M. dhe H.K., të dhëna më 23 maj 2012, dëshmitë e dëshmitarëve S.Th. dhe F.B., të cilët dëshmuan në gjykatë më 24 maj 2012, dëshmitë e I.V., Z.V., R.D., A.H., D.K. dhe A.E., të dhëna më 29 maj 2012, dëshmitë e B. i M., D.G., F.Sh., të dhëna më 24 korrik 2012, dëshmitë e M.F.dhe L.H., të dhëna më 25 korrik 2012, dëshmitë e B.A., R.Z. dhe F.Z., të dhëna më 8 nëntor 2012, dhe dëshmia e I.Sh., me nofkën H., e dhënë më 20 nëntor 2012.

Vlerësimi i hollësishëm i këtyre provave do të paraqitet më vonë bashkë me gjetjet lidhur me secilin prej të pandehurve.

Gjykata i vlerësoi si të besueshme dëshmitë e dhëna nga F.F., S.B., Gj.L, S.Th., S..M., S.O., E.M., H.K., I.V., Z.V., R.D., A.H., D.K., A.E., B.M. dhe F.Sh.. Duhet theksuar se pothuajse të gjithë këta dëshmitarë dëshmuan në përputhje me deklaratat e tyre në procedurën paraprake dhe në fakt nuk mohuan ndonjë rrethanë që ata paraqitën në atë fazë të procedurës. Në të njëjtën kohë, u duk se asnjëri



prej tyre nuk është aspak i gatshëm t'i fajësojë të akuzuarit. Për më tepër, në fakt asnjëri nga dëshmitarët nuk shprehu ndonjë pakënaqësi kundër akuzuarve. Trupi gjykues erdhi në përfundimin se disa mospërputhje dhe papajtueshmëri të vogla në dëshmitë e dëshmitarëve ishin rezultat i kalimit të kohës dhe mangësi natyrore të kujtesës njerëzore. Në fakt, këto mospërputhje dhe papajtueshmëri e siguruan trupin gjykues se dëshmitë ishin plotësisht spontane dhe nuk ishin sajuar paraprakisht nga dëshmitarët.

Trupi gjykues i gjeti të besueshme edhe dëshmitë e dy policëve të Kosovës, D.V. dhe D.G. Faktet lidhur me marrjen në pyetje të F.F. dhe N.A. ata i paraqitën në mënyrë të logjikshme dhe spontane, dhe materiali provues i pranuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kishte elemente që do të kundërshtonin bindshëm versionin e tyre të ngjarjeve.

Krahas këtyre, trupi gjykues i gjeti të besueshme dëshmitë e dy dëshmitarëve të mbrojtjes, R.Z. dhe F.Z. Deklaratat e tyre ishin logjike, koherente dhe përputheshin me faktet e njohura gjerësisht lidhur me lëshimin e pasaportave biometrike të Serbisë.

Trupi gjykues nuk pati dyshime për besueshmërinë e identifikimit të disa prej të akuzuarve, i kryer nga dëshmitarët F.F. dhe N.A. gjatë procedurës paraprake. Duket se mënyra se si dëshmitarët u pyetën nga policia për të identifikuar të dyshuarit nga albumi i fotografive me foto të personave të ndryshme, nuk ishte në përputhje me nenin 225 paragrafi 1 të KPPK-së. Si rregull i përgjithshëm, së pari dëshmitarët duhet t'i kërkohet të bëjnë një përshkrim

dhe të tregojë tiparet dalluese të personit për t'u identifikuar. Në vend që të veprohej në përputhje me këtë rregull, dëshmitarëve iu tregua vetëm foto-albumi nga oficeri që i mori në pyetje. Pavarësisht këtij mosveprimi, trupi gjykues erdhi në përfundimin se rrethanat në të cilat ndodhën identifikimet, i dhanë secilit prej dëshmitarëve mundësinë të bëjnë zgjedhje të paanshme bazuar në vëzhgimet faktike të të dyshuarve në kohën e ngjarjeve inkriminuese.

Trupi gjykues vlerësoi në mënyrë kritike dëshmitë dhe provat e dhëna në gjykatë nga dëshmitarët L.H. dhe B.A. L.H. mohoi çdo përfshirje të të akuzuarit A.B. në organizimin e udhëtimit jashtë vendit të vëllait të saj, M.H., me gjithë faktin se ajo i paraqiti faktet relevante ndryshe gjatë hetimit dhe që u konfirmuan nga dëshmitari I.H. (Sh.). Prandaj trupi gjykues u mbështet në deklaratat e L.H. në procedurën paraprake. B.A. dha dëshmi që ishte në kundërshtim me faktet e vërtetuara sipas deklaratës së dhënë në procedurën paraprake nga vëllai i tij, N.A..

Trupi gjykues e gjeti të besueshme dëshminë e dhënë nga F.B.. Megjithëse nuk u tregua e gatshme për të kujtuar ndonjë hollësi të ngjarjeve që kishte përshkruar në procedurën paraprake, ajo në të vërtetë konfirmoi në gjykatë çdo gjë që kishte paraqitur më parë. Ajo tha se miku i saj S.Gj. ishte i interesuar të shkonte jashtë shtetit dhe ajo e diskutoi këtë me një person të caktuar në një kafene në Prishtinë. Megjithatë, as në dëshminë e saj në procedurën paraprake, as përpara trupit gjykues ajo nuk qe në gjendje të japë më shumë hollësi në lidhje me përmbajtjen e atij diskutimi. Ajo tregoi se ai person ngjante me N.B. ose B.B., pa ndonjë tregues të mëtejshme që

do të ndihmonte për ta identifikuar atë person me siguri. S.Gj. nuk u arrit të sillej për të dëshmuar në gjykatë pasi trupi gjykues ka marrë informacione se ajo është larguar nga Kosova përgjithmonë. Palët nuk kishin asnjë mundësi për të kundërshtuar duke i bërë pyetje lidhur me deklaratën e saj të dhënë në procedurën paraprake. Prandaj, në bazë të nenit 156 paragrafi 2 të KPPK-së, ajo deklaratë nuk mund të pranohej si dëshmi. Kësisoj, faktet e përdorura nga F.B. nuk kontribuojnë në ndonjë gjetje që do të ishte relevante për akuzat e përcaktuara në aktakuzë.

Nuk pati dyshime në lidhje me pranueshmërinë dhe saktësinë e provave të mëposhtme që u paraqitën në shqyrtimin gjyqësor:

- raportet mbi përgjimin e telekomunikimeve dhe SMS-ve, nr. 2011 - DKKO - 005, datë 25.02.2011, 21.03.2011, 13.04.2011, 24.04.2011, 25.04.2011, 27.04.2011, 11.05.2011, 12.05.2011, 15.05.2011, 25.05.2011, 26.05.2011, 01.06.2011, 09.06.2011, 2011/06/11, 15.06.2011, 25.07.2011, 27.07.2011, 01.08.2011, 08.08.2011;
- raportet e telefonatave 2011-DKKO-005, datë 19.10.2011 dhe 24.10.2011
- raporti mbi hetimet financiare, nr 14-DKKO-SHFI-2011/6, datë 25.08.2011

Krahas këtyre, trupi gjykues ka pranuar dhe shqyrtuar provat e mëposhtme:

- raportet mbi kontrollin e shtëpive të të pandehurve dhe sendet e konfiskuara, nr. 2011-DKKO - nr. 005, datë 11.06.2011,

- raporti 2011 - DKKO - 005, 2011 - SFTI - 053, datë 06.10.2011, në lidhje me ekzaminimin e telefonave që iu konfiskuan të pandehurve B.N., N.B., B.B, A.B., M.B. dhe S.B.,

Këto prova u morën në përputhje me kërkesat procedurale përkatëse dhe origjinaliteti i tyre nuk u kundërshtua nga asnjë prej të akuzuarve ose mbrojtësve të tyre.

Trupi gjykues vlerësoi pozitivisht besueshmërinë dhe vërtetësinë e Ekspertizës 2011-1584/2011-1672, datë 08.09.2011 lidhur me sendet dhe mjetet që iu konfiskuaran të pandehurit M.B., dhe pasaportat e H.K. dhe B.Th. Konkluzionet e tij kishin natyrë shumë të përgjithshme, por ato janë të bazuara mirë nga përshkrimi i metodës së analizës mjeko-ligjore të kryera nga eksperti policor.

#### **Rindërtimi i fakteve dhe vlerësimi ligjor i gjetjeve**

Faktet e mëposhtme janë vërtetuar nga trupi gjykues si rezultatet e vlerësimit të të provave nga ana e tij:

#### **Në lidhje me B.N.**

Dikur nga fundi i vitit 2007 dhe fillimi i vitit 2008, B.N. hapi një agjenci turistike. Ai shiste bileta udhëtimi dhe bashkëpunonte edhe me agjenci të tjera turistike duke lëshuar bileta për udhëtimet e kryera nga ana e tyre. Një pjesë e veprimtarisë së tij lidhej me dhënien e ndihmës për qytetarët e Kosovës të cilët dëshironin të aplikonin për pasaportë biometrike serbe.

Trupi gjykues mori njoftim gjyqësor të fakteve lidhur me lëshimin e pasaportave nga autoritetet serbe për qytetarët e Kosovës. Republika e Serbisë e nisi lëshimin e pasaportave biometrike d.m.th. pasaportave të përbëra nga shënimi i dhënave biometrike të mbajtësit të saj, më 7 korrik 2008. Mbajtësit e këtij lloji të pasaportës mund të udhëtonin lirisht në disa vende fqinje, përfshirë Hungarinë, edhe pse ata nuk mund të qëndronin atje më gjatë se tre muaj. Që nga viti 1999, pas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244/99 të OKB-së, Republika Serbisë nuk ka pasur mundësi për bëjë ndonjë verifikim lidhur me personat që banojnë në Kosovë. Megjithatë, në fakt, njerëzit e lindur në Kosovë ose përndryshe ligjërisht të vendosur në Kosovë janë konsideruar nga autoritetet serbe si shtetas serbë dhe sipas procedurës administrative serbe ata kanë pasur të drejtë të marrin pasaporta serbe. Gjatë dialogut për liberalizimin e vizave mes Serbisë dhe Bashkimit European, Komisioni European vuri në dukje se nxjerrja nga Serbia e pasaportave të reja biometrike për personat që banojnë në Kosovë nuk garantonte verifikimin e duhur të saktësisë së të dhënave të dorëzuara nga personat që banojnë në Kosovë, kur të aplikonin për pasaporta të reja biometrike serbe. Në mënyrë që të zbatoheshin rekomandimet e Komisionit European dhe të parandalohesh abuzimi me këtë situatë në aplikimet për pasaporta biometrike, autoritetet serbe njoftuan ngritjen në korrik të vitit 2009 në Beograd të një Drejtorisë së posaçme të Koordinimit (në serbishte: *Koordinaciona Uprava*), e ngarkuar vetëm me përpunimin e të gjitha aplikimeve për pasaportë, të paraqitura nga persona që banojnë në Kosovë dhe persona certifikata e shtetësisë e të cilëve është lëshuar për territorin e Kosovës nën UNSCR 1244/99. Më 19 dhjetor 2009, Rregullorja nr. 539/2001 e

Këshillit European listoi vendet e treta shtetasit e të cilave duhet të kenë viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm të zonës Shengen, dhe lista e vendeve shtetasit e të cilave përjashtohen nga ky detyrim u ndryshua, në mënyrë që të përjashtoheshin mbajtësit e pasaportave të lëshuara nga Drejtoria e Koordinimit. Për të marrë pasaportë të rregullt serbe, që lejon hyrjen pa vizë në zonën Shengen, qytetarët e Kosovës duhet të ketë deklaruar vendbanimin e tyre në pjesë të tjera të Serbisë.

Nuk u vërtetua se çfarë lloj pasaportash kishin marrë klientët e B.N. në Serbi me ndihmën e tij. Krahas dhënies së informacionit përkatës, shërbimet e B.N. mbulonin edhe organizimin e transportit të klientit për në Serbi, ndonjëherë duke e shoqëruar atë në udhëtim, si dhe rregullimin e tij / akomodimin e tij në Serbi, ndërkohë që ishte në pritje të lëshimit të pasaportës.

Gjetjet e paraqitura më sipër janë bazuar në deklaratën e të pandehurit dhe janë vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve R.Z. dhe F.Z. të cilat u vlerësuan të besueshme për shkak të logjikës dhe përputhjes së tyre me faktet e ditura përgjithësisht që lidhen me procedurën për marrjen e pasaportave serbe.

Në vitin 2011, B.N. u takua me F.Sh. dhe bisedoi me të rreth rregullimit të dokumenteve të udhëtimit për gruan e tij. Meqenëse gruaja e tij kërkonte trajtim mjekësor, F.Sh. ishte në kërkim të mundësisë për të marrë vizë për të hyrë në zonën Shengen. B.N. nuk i ofroi ndonjë ndihmë në këtë drejtim, por i tha atij se mund ta ndihmonte të merrte pasaportë serbe, kundrejt një shpërblimit të përgjithshëm

në shumën e 5000 eurove. F.Sh. nuk i interesoi kjo ofertë. Këto fakte janë vërtetuar në bazë të dëshmive të F.Sh. dhe A.E., të cilat e vërtetojnë njëra-tjetrën plotësisht dhe tërësisht.

Për shkak të veprimtarisë së tij profesionale, B.N. u angazhua në biseda të shumta me N.B., B.B, S.B., A.B. (vide-raporti nr. 2011-DOC-005, datë 19.10.2011, raporti nr. 2011-DOC-005, datë 24.10.2011). Për shembull, më 27.04.2010, në orën 11:53:27, ai mori një telefonatë nga B.B, i cili i tha *"Kanë mbetur dy djem në Suboticë, vendndodhja e tyre është Hotel Palma dhe numri i tyre i telefonit është xxx.* Pak minuta më vonë ai mori këtë tekst-mesazh nga B.B *"Largoji nga hoteli dhe dërgoji në vendin ku po qëndron ti."* Kjo bisedë tregon qartë një veprim të bashkërenduar në mes të B.N. dhe B.N., që mbështetej në mundësimin e kalimit të kufirit ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë nga dy persona të paidentifikuar. Megjithatë, në favor të të akuzuarve, trupi gjykues hamendësoi se këta persona të paidentifikuar ishin në zotërim të pasaportave serbe.

Më 29 prill 2011, në orën 14:10:51, B.N. u angazhua në një bisedë telefonike me B.B. në lidhje me rregullimin e një kalimi ilegal të kufirit nga dy persona të paidentifikuar. Megjithatë, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u vërtetua nëse kjo bisedë rezultoi në ndonjë veprim të mëtejshëm. Sidoqoftë, kjo bisedë u konsiderua si provë që vërtetonte deklaratën e dëshmitarit S.Th., sepse tregon qartë se B.N. i kishte kontaktet dhe njohuritë e nevojshme për të organizuar kalim të paligjshëm të kufirit.

Gjithashtu, B.N. u angazhua në transaksione të ndryshme financiare me njerëz që jetonin jashtë vendit, kryesisht në Serbi dhe Gjermani (Raporti Policor video-përmbledhës nr. 14-DHKO-SHFI-2011/6, i datës 25.08.2011 lidhur me hetimet financiare). Ky Raport përfshinte personat e quajtur A.M. dhe I.V., E.M., L.S. dhe K.A. Megjithatë, nuk u vërtetua se ndonjëri prej këtyre transaksioneve kishte lidhje me veprat me të cilat u akuzua ose me ndonjë veprimtari tjetër kriminale.

Në disa raste B.N. u konsultua me M.B. për çështjen e autenticitetit dhe vërtetësisë së dokumenteve që mendohej të përdorehin nga klientët e B.N. në procedurën administrative para autoriteteve serbe, me qëllim që të merrej pasaporta biometrike.

Trupi gjykues erdhi në përfundimin se asnjë prej aktiviteteve të përshkruara më lart të B.N. nuk mund të konsiderohet si vepër penale. Në veçanti, ndihma për marrjen e pasaportës serbe nga një shtetas i Kosovës nuk penalizohet. Biseda lidhur me kalimin e paligjshëm të kufirit, që u zhvillua më 29 prill 2011, nuk çoi në ndonjë veprim të mëtejshëm dhe, për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet as si veprim përgatitjeje.

Dikur nga data 1 qershor 2011 deri më 10 qershor 2011, në kafenenë në Prishtinë, B.N. u takua me B.Th., i cili ishte shtetas dhe banor i Kosovës. Ata ranë dakord që B.N. të mundësonte hyrjen e tij të paligjshme në Austri. Për këtë shërbim, B.N. mori 1800 euro. Me ndihmën e B.N., B.Th. shkoi në Serbi me autobus dhe pastaj në mënyrë të papërcaktuar ai shkoi në Austri. Ndonëse detajet e hyrjes



së B.Th. në zonën Shengen mbeten të paqarta, trupi gjykues vlerësoi se veprimet e B.N. u provuar. Kjo u vërtetua mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga S.Th. Deklarata e S.Th. iu duk trupit gjykues e logjikshme dhe konsekuente dhe për këtë arsye plotësisht e besueshme. Nuk pati asnjë dyshim për identifikimin e B.N. të bërë nga dëshmitari gjatë procedurës paraprake. Kushtet në të cilat u krye identifikimi i dhanë dëshmitarit mundësinë të bënte zgjedhjen e tij pa ndonjë sugjerim apo aludim të parregullt nga ana e hetuesve. Zgjedhja e tij u bërë në përputhje me përshkrimin e të akuzuarit që dëshmitari kishte paraqitur para se të bëhej identifikimi.

Aktiviteti i përshkruar më lart i B.N. u klasifikua nga trupi gjykues si vepër penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të datës 20 prill 2012 (KPRK). Sipas Nenit 170 Paragrafi 8 nën-paragrafi 8.1, kontrabandimi me migrantë do të thotë çdo veprim me qëllimin për të siguruar përfitim, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përfitim financiar ose përfitim tjetër pasuror, nga hyrja e paligjshme e një personi në Republikën e Kosovës, kur ky person nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, ose hyrja e një personi, i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose shtetas i huaj, në një shtet në të cilin ky person nuk është banor i përhershëm ose shtetas i atij shteti.

Trupi gjykues mori parasysh ndryshimin në ligjin material që ndodhi pas kohës së kryerjes së krimit dhe para kohës së dënimit. Trupi gjykues krahasoi dispozitat ligjore të parashikuara nga ligji që ishte në fuqi para hyrjes në fuqi

të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të 20 prillit të vitit 2012. Sipas "kudit të vjetër", d.m.th. Kodit Penal të Kosovës të vitit 2008, vepra korresponduese e kontrabandës me migrantë, dënohej nga neni 138 paragrafi 1, që parashikon dënim nga 2 deri në 12 vjet, ndërsa "kodi i ri" parashikon dënim nga 2 deri në 10 vjet burgim për të njëjtën vepër penale. Prandaj, ligji i ri duket më i favorshëm për të akuzuarin, dhe, për këtë arsye, në bazë të nenit 3 paragrafi 2, në këtë rast duhet të zbatohet ky ligj. Të njëjtat mendime lidhur me klasifikimin ligjor dhe zbatueshmërinë e ligjit të ri vlejné edhe për të pandehurit e tjerë të cilët janë gjetur fajtor për kontrabandim me migrantë dhe vepra penale e të cilëve përshkruhet më poshtë në këtë aktgjykim.

#### **Në lidhje me N.B.**

N.B. (në mënyrë të ngjashme me B.N.) administronte një agjenci turistike. Pavarësisht nga mohimet e tij të paraqitura në deklaratën e tij, ai kishte shumë kontakte biznesi me B.N..

Ndërmjet 1 janarit dhe prillit 2011, N.B. pati kontakte me shqiptarët e Kosovës që jetonin në Kosovë, përkatësisht P.V., B.V. dhe Z.H., të cilët planifikonin të emigronin nga Kosova, përkundër faktit se ata nuk ishin në posedim të dokumenteve të nevojshme të udhëtimit. N.B. organizoi një udhëtim me autobus për ta nga Kosova në Serbi dhe pastaj në mënyrë të papërcaktuar ai organizoi kalimin ilegal të kufirit ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë për ta. Ata qëndruan në Serbi për 3-4 ditë dhe pastaj diku në afërsi të qytetit të Suboticës ata kaluan në këmbë kufirin ndërmjet Serbisë

dhe Hungarisë. N.B. u pagua 1800 euro për çdo migrant, duke bërë një total prej 5.400 eurosh.

Me këtë veprim, N.B. kreu veprën penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në prill të vitit 2011, menjëherë pasi P.V., B.V. dhe Z.H. kishin shkuar jashtë vendit, N.B. organizoi një udhëtim me autobus për në Serbi për S.V., i afërm i P.V. dhe B.V.. Ai ishte gjithashtu shqiptar i Kosovës dhe nuk kishte asnjë dokument të nevojshëm udhëtimi për të hyrë në zonën Shengen. N.B. organizoi kalimin nga S.V. të kufirit ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë, megjithëse detajet e këtij kalimi të kufirit mbeten të panjohura. Për këtë shërbim N.B. mori 2200 euro. Faktet e paraqitura më lart u provuan nga dëshmitë e Z.V. dhe I.V.. Të dy dëshmitë vërtetuan njëra-tjetrën dhe paraqitën një version koherent të ngjarjeve. Ato patën mospërputhje në lidhje me shumën e parave që iu pagua të akuzuarit për shërbimin e tij, por kjo duket se është pasojë e natyrshme e kalimit të kohës së gjatë dhe humbjes së kujtesës njerëzore. Mospërputhje pati edhe në mes versioneve të paraqitura nga dëshmitarët në fazën e procedurës paraprake dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me konfigurimin e të dëmtuarve. Fillimisht dëshmitarët treguan se P.V., B.V. dhe Z.H. shkuan jashtë shtetit në fillim dhe më pas ata u pasuan nga S.V.. Duket se I.V. nuk i dinte të gjitha detajet e emigrimit të djalit të tij, pasi ai nuk e kishte miratuar atë. Prandaj, trupi gjykues arriti në përfundimin se versioni i ngjarjeve të paraqitura nga dëshmitari Z.V. në procedurën paraprake duket si më i mundshëm sepse ajo deklaratë u dha menjëherë

pas ngjarjeve që dëshmitari përshkroi në këtë kohë. Më tej, dallimet lidhur me shumën e paguar për N.B. duket se janë shkaktuar nga shpenzimet e tjera të mbuluara nga dëshmitari me rastin e largimit të djalit të tij nga vendi. Ky veprim i N.B. përbënte gjithashtu veprën penale të kontrabandimit me migrantë, në shkelje të nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së.

Më 10 maj 2011, N.B. hyri në bisedë telefonike me S.B.. S.B. ishte i interesuar të shkonte jashtë vendit së bashku me një person tjetër. N.B. ra dakord t'i kontrabandonte ata përmes kufijve. Personi tjetër ishte F.F., S.B. dhe F.F. ishin shqiptarë të Kosovës, të cilët jetonin në Kosovë dhe të dy donin të shkonin në Austri pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit. N.B. u mori atyre fotografi të llojit për pasaportë. Më 10 qershor 2011, N.B. organizoi transportimin me autobus të S.B. dhe F.F. për në Republikën e Serbisë. Ata të dy hipën në autobus në urën në Klinë. Në Prishtinë, N.B. e pajisi S.B. me pasaportë të rregullt nr. xxx, pasaportë e H.K., e lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, e ndryshuar nga një person i paidentifikuar duke zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografinë e S.B. Ai e pajisi edhe F.F. me pasaportë të rregullt nr. Xxx, pasaportë e B.Th., e lëshuar nga Republika Federale e Jugosllavisë, e ndryshuar nga M.B. duke zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografinë e F.F. S.B. dhe F.F. mendohej të shkonin në Suboticë në Serbi. Atyre iu premtua se do t'i merrnin në Suboticë me taksi dhe pastaj ata planifikonin të shkonin në këmbë në Hungari dhe në mënyrë të papërcaktuar për në Austri. Ata ranë dakord ta paguanin N.B.n 2000 euro secili pas mbërritjes së tyre në Austri. S.B. dhe F.F. nuk e

arritën qëllimin e tyre, sepse u arrestuan nga policia në vendkalimin kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si rezultat i procedurave të kontrollit të dokumenteve. Këto ngjarje u vërtetuan nga trupi gjykues kryesisht mbi bazën e tablateve të një bisede telefonike që u zhvillua më 10 maj 2011 në orën 16:00:51 midis N.B. me numrin e telefonit xxxx dhe numrit të telefonit xxx, të përdorur nga S.B., dhe mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga F.F. në procedurën paraprake. Versioni i tij në atë kohë ishte bindës dhe logjik. Në gjykatë ai pretendoi se donte të shkonte në Austri në mënyrë të ligjshme dhe se ai nuk e kishte kuptuar se pasaporta që ishte lëshuar në një emër tjetër me fotografi të tij të bashkangjitur, ishte e falsifikuar. Lidhur me identifikimin e N.B., i bërë nga F.F. në procedurën paraprake, nuk pati asnjë dyshim. Dëshmitë e dhëna nga oficerët e policisë D.V. dhe D.G. përshkruan në detaje se si u realizua identifikimi dhe deklaratat e tyre ishin plotësisht bindëse.

Deklarata e F.F. e dhënë në procedurat paragjyqësore u konfirmua edhe nga dëshmia e paraqitur nga M.F. edhe pse dëshmitari nuk i dinte të gjitha detajet e veprimeve të ndërmarra nga F.F. dhe S.B.

Pasi që qëllimi penal nuk ishte arritur, veprimi i përshkruar më sipër i N.B. përbën tentative për kontrabandim të migrantëve në pajtim me nenin 170 paragrafi 1 të KPRK dhe nenit 28 paragrafet 1 dhe 2.

Të gjithë të permendurit me lart kanë përshkruar tre veprat penale që N.B. ka kryer në vazhdimësi siç përcaktohet nga neni 81 paragrafi 1 të KPRK. Ky përfundim është i bazuar në

konstatimet që N.B. në të gjitha rastet perfitoi nga situata e njëjtë dmth ekzistenca e kufizimeve të udhëtimit për qytetarët e Kosovës, e cila korrespondon me nenin 1 paragrafi 1 nenparagrafi.1.3.). Për më tepër, veprimet e tij kriminale janë kryer në të njëjtën hapësirë, gjegjësisht në territorin e Kosovës dhe Serbisë që korrespondon me nenin 1 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4.

Nga transkriptimet e bisedave telefonike të shumta është percaktuar që N.B. ka pasur komunikime ekstensive telefonike dhe komunikime SMS me B.N., N.B., B.B dhe A.B. dhe gjithashtu M.B. (shih Nr 2011-DKKO - 005, datë 19.10.2011, raportet e policisë policisë raportet e dates 13/04/2011, 25/04/2011, 11.05.2011, 26.05.2011, 27.07.2011. Përmbajtja e mesazheve tekst dhe bisedat e përgjuara tregojne se subjekti i këtij komunikimi ishte i lidhur me njerëzit që kalonin kufij të ndryshem dhe dokumentet e udhëtimit. Megjithatë, trupi gjykues erdhi në përfundim se këto pjesë të dëshmimeve nuk mund të çojne në përfundimin se ky komunikim ka lidhje me kontrabandën e emigrantëve dhe jo vetëm lehtësimin e udhëtimit për njerëzit kane qenë në posedim të dokumenteve të vlefshme të ndryshme të udhëtimit, duke përfshirë pasaportat serbe.

#### **Ne lidhje me B.B. dhe A. B.**

Në prill 2011 A. M., një shtetas i Republikës së Kosovës, vendosi të shkojë në Gjermani. Ai ishte në posedim të një pasaporte të Kosovës dhe vize gjermane, por i kishte skaduar viza. Në një mënyrë të papërcaktuar ai hyri në një marrëveshje me B.B. dhe A. B. Ata organizuan një udhëtim me autobus për atë në Serbi. Ata të dy u takuan me A. M. në

vendkalimin kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Merdare. Pas udhëzimeve të tyre, A.M. hipi në një autobus që vinte nga Prizreni dhe shkoi në Suboticë në Serbi, ai kaloi një natë atje dhe më pas, duke përdorur aranzhimet e bëra aty nga të akuzuarit, ai kaloi kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë në këmbë. Pastaj në një mënyrë të papërcaktuar ai shkoi në Austri. Pas mbërritjes së tij në Austri, ai urdhëroi babain e tij për të paguar 1800 euro njerëzve që e kishin kontrabanduar atë jashtë Kosovës. Babai i tij, E.M. pagoi paratë nëpërmjet një ndërmjetësi të papërcaktuar në fshatin Luzhan. Këto konstatime janë bërë mbi bazën e dëshmisë së dëshmitarit S.M. e cila u konfirmua nga dëshmitë e B.M. dhe E.M. Të gjitha këto deklaratat plotësojnë njëra-tjetrin dhe nuk përmbajnë asnjë mospërputhje. Në deklaratën e tij të dhënë në gjykatë E.M. devijoi nga depozitimet e tij të mëparshme, ndërsa tregon sasinë e parave që ai pagoi. Duke pasur parasysh se dëshmitari ishte një person i moshuar gje që shpjegon një mungesë perfeksioni në kujtesën e tij paneli percaktoi sasinë e parave që u pagua në të vërtetë nga ana e dëshmitarit duke iu referuar deklaratës së tij në procedurën paraprake në këtë drejtim. Paneli mori në konsideratë që gjatë identifikimit të kryer në procedurat paragjyqësore dëshmitari S.M. nuk ishte absolutisht i sigurt se ai kishte identifikuar të akuzuarit si personat me të cilët ai u takua në Merdare. Në atë kohë atij i janë treguar 8 fotografi dhe vetëm ai tregoi një probabilitet që B.B. dhe A.B. ishin në fakt personat në fjalë. Trupi gjykues erdhi në përfundim se ekzistojnë fakte të cilat mbështesin fuqimisht këtë identifikim. Këto fakte janë: një komunikim ekstensiv mes dy prej të akuzuarve i cili u përmend më lart dhe përmbajtja e komunikimit, kur në raste

të tjera të akuzuarit kishin diskutuar transportimin e njerëzve jashtë vendit. Prandaj, identifikimi i bërë nga dëshmitari nuk duket si rastësi, por si krejtësisht i sakte.

Paneli erdhi në përfundim se nga veprimet e mësipërme B.B dhe A.B. kane kryer veprën penale bashkëkryerje në kontrabandimin e migrantëve në pajtim me nenin 170 paragrafi 1 dhe nenit 31 të KPRK.

### **Ne lidhje me B.B dhe Z.Z.**

Në mars 2011 B.B u takua me Z.Z. dhe E.I. E.I. ishte një qytetar dhe banor i Kosovës. Ai i tha B.B se ai do të donte të shkonte jashtë, por ai nuk kishte asnjë dokument të nevojshëm të udhëtimit. Z.Z. ra dakord të paguajë B.B. ne shumën prej 1.650 Euro për kontrabandimin e E.I. Menjëherë pas kësaj në një mënyrë që mbetet e pazbuluar gjatë shqyrtimit kryesor B.N. organizoi një udhëtim për E.I. në Zvicër. E.I. shkoi atje pa kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në këtë vend. Z.Z. i transferoi B.B 1250 Euro nëpërmjet shërbimit MoneyGram. Shumen e mbetur prej 400 Euro Z.Z. ia dorëzoi B. N. në tregun e bagëtisë në Rugovë te Hasit. Këto fakte janë percaktuar në bazë të deklaratës të akuzuarit Z.Z. e dhënë në procedurën paraprake. Z.Z. ka konfirmuar këtë deklaratë në shqyrtimin gjyqësor. Ai prezantoi faktet në një mënyrë logjike dhe bindëse dhe për këtë arsye trupi gjykues gjeti versionin e tij si plotësisht të besueshem. U vërtetua nga përmbajtja e bisedës telefonike mes B.B. dhe Z.Z. datë 30.03.2011 i cili iu referua pagesës se mësipërme te përshkruar. Përsëri, deklarata e Z.Z. në përputhje me dëshmitë e tjera të



përmendura më lart tregon përfshirjen e B.B. në transportimin e njerëzve jashtë vendit.

Ky veprim i kryer nga B.B. përbën veprën penale të Kontrabandës së Migrantëve në pajtim me nenin 170 paragrafi 1 të KPRK. Paneli mori parasysh se roli i Z.Z. në kryerjen e veprës është mjaft i kufizuar pasi ai vetëm ka vepruar si një garantues dhe paguesi në emër të personit të kontrabanduar. Ky aktivitet nuk ishte aq i rëndësishëm sa që mund të konsiderohet si bashkëkryerje. Andaj Paneli konkludoi se Z.Z. ka kryer veprën penale të asistencës me kontrabandimin e migrantëve në pajtim me nenin 170 paragrafi 1 dhe neni 33 i KPRK.

Duke marrë në konsideratë dy prej veprave me të cilat akuzohet B.B. Paneli konkludoi se B.B. i kreu këto vepra penale në vazhdim, siç përcaktohet në nenin 81 të KPRK, sepse në të dyja rastet ai perfitoi nga situata e njëjtë dmth ekzistenca e kufizimeve të udhëtimit për qytetarët e Kosovës që i korrespondon Nenit 1 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3. dhe veprimet e tij kriminale janë kryer në të njëjtën hapësirë, gjegjësisht në territorin e Kosovës dhe Serbisë që korrespondon me nenin 1 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4.

Ka pasur disa biseda telefonike mes B.B. dhe Z.Z. të regjistruara që tregojnë se ata ishin duke folur në lidhje me kontrabandën e njerëzve jashtë vendit. Më 12 prill 2012 Z.Z. pyeti B.B. në qoftë se ai mund të kontrabandonte një person në Angli për 5000 Euro. B.B. u përgjigj se çmimi duhet të jetë jo më pak se 6500 Euro. Megjithatë, nuk ka

asnjë tregues se kjo bisedë ka rezultuar në ndonjë veprim të mëtejshëm për këtë arsye ajo nuk mund të konsiderohet si një vepër penale në vetvete.

### **Ne lidhje me A.B.**

Në shtator 2010 M.H. një shtetas i Republikës së Kosovës vendosi të shkojë në Zvicër. Ai nuk kishte asnjë dokument të udhëtimit të nevojshëm për të hyrë në këtë vend. A.B. i mundesoi atij një dokument udhëtimi falso. M.H. e ka përdorur këtë dokument për të udhëtuar për në Turqi dhe nga Turqia për në Zvicër. Për këtë shërbim M.H. premtoi ti paguajë A.B. 1100 Euro. Kjo nuk u zbulua gjatë shqyrtimit kryesor, se si A.B. përfitoi dokumentin mashtrues dhe çfarë lloji i dokumentit ishte. E as që ishte përcaktuar nëse A.B. ka pranuar pagesën. Këto fakte të mësipërme janë përcaktuar nga trupi gjykues në bazë të dëshmive të dhëna në gjyq nga dëshmitari I.H.(Sh). Dëshmitari paraqiti versionin e tij të ngjarjeve në një mënyrë spontane dhe logjike. Ai pranoi se ai gjithashtu donte për të shkuar jashtë shtetit. A.B. i ofroi atij për ti marrë një pasaportë falso për 1100 Euro. Shuma e parave që M.H. është dashur të paguajë për A.B. u vërtetua nga trupi gjykues nga oferta që A.B. i bëri M.H. Dëshmia e I.H.(Sh.) është plotësisht e mbështetur nga deklaratat e L.H. dhënë në procedurat paraprake. Në gjykatë ajo dëshmoi në një mënyrë të paqartë duke mohuar njohuri të faktit se M.H. shkoi jashtë vendit ilegalisht dhe kontestimin e identifikimit të A.B. mbi bazën e numrit të telefonit që ai përdorte. Trupi gjykues gjeti se dëshmia e saj nuk është e besueshme për shkak se bie ndesh me sensin e përgjithshëm të kuptuarit dhe se bie ndesh padyshim me deklaratën e saj të mëparshme.

A.B. u identifikua pikërisht nga dëshmitari I.H.(Sh). dhe ky identifikim është përsëritur si identifikimi i bere nga dëshmitari në gjykatë i ashtuquajtur "në bankën e të akuzuarve". Nuk ka dyshime se A.B. ishte njeriu i përshkruar nga L.H. dhe I.H.(Sh). si ai që mundesoi M.H. dokumentin falso te udhëtimit.

Prandaj, A.B. ka kryer veprën penale të Kontrabandës së Migrantëve duke siguruar dokumente të rreme të udhëtimit në pajtim me nenin 170 paragrafi 2 të CCRK.

Paneli erdhi në përfundim se nuk ka elemente që do të lejojnë klasifikimin e dy veprave që i atribuohen A.B. si një krim në vazhdim, siç përcaktohet në nenin 81 paragrafi 1 të KPRK. Dallimi mes veprimeve të atribuara këtyre të akuzuarve dhe veprave të kryera nga B.B dhe N.B. janë të lidhura me hapësirën e kryerjes së krimit. Krimi i sigurimit të dokumente të rreme të udhëtimit ka lidhje me Kosovën dhe Turqinë, ndërsa të gjitha veprat e tjera merren kryesisht me Kosovën dhe Serbinë.

Duhet theksuar se sanksionet penale të parashikuara për sigurimin e dokumenteve të rreme të udhëtimit, si një formë e kontrabandimit të emigrantëve duket të jenë të njëjta sipas kodeve të vjetra dhe të reja. Megjithatë, veprat e tjera të kryera nga A.B. duhet të klasifikohen sipas kodit të ri (shih vërejtjet në nenin 170 paragrafi 1 më sipër) dhe dënimet e shqiptuara për secilën prej veprave penale duhet të merren në konsideratë kur të imponohet një dënim unik. Prandaj kodi i ri krijon një situatë më të favorshme për A.B.

## **Ne lidhje me A.B. dhe A.P.**

Në shtator 2010, A.P. ka kontaktuar A.B.n dhe i tha atij se I.P., një qytetar i Kosovës, ka kërkuar për të shkuar jashtë shtetit. I.P. nuk i kishte dokumentet e nevojshme të udhëtimit. A.P. ika paguar A.B. 2200 Euro për kontrabandimin e I.P. jashtë vendit. A.B. organizoi një udhëtim në Serbi dhe pastaj në Austri për I.P. Ka mbetur e pazbuluar se si I.P. arriti të kalonte kufirin në mes të Serbisë dhe zonës Shengen. Me këtë veprim A.B. ka kryer veprën penale të kontrabandimit të migrantëve sipas nenit 170 paragrafi 1 të KPRK. Veprimi i I.P. përbën ndihmë në kontrabandimin e migrantëve sipas nenit 170 paragrafi 1 dhe neni 33 paragrafi 2 i KPRK.

Diku pasi I.P. u largua nga Kosova, A.P. vuri në kontakt A.B. me L.C. i cili gjithashtu donte të emigronte nga Kosova. L.C. ishte një qytetar i Kosovës dhe nuk kishte asnjë dokument të udhëtimit të nevojshëm për të shkuar jashtë shtetit. A.P. ka paguar A.B. 2200 Euro për kontrabandimin e L.C. nga Kosova në Austri. Kjo është marrë nga A.P. prej babait të L.C. A.B. organizoi një udhëtim në Serbi dhe pastaj në Austri për L.C. Ka mbetur e pazbuluar se si I.P. arriti të kalonte kufirin në mes të Serbisë dhe zonës Shengen. A.P. nuk ka përfituar dobi pasurore për vete për të ndihmuar I.P. apo L.C.

Këto fakte janë percaktuar mbi bazën e deklaratave vetë-inkriminuese të dhëna nga A.P. në procedurën paraprake. A.P. plotësisht ju është referuar këtyre deklaratave gjatë shqyrtimit kryesor. Versioni i tij i ngjarjeve atëherë nuk

ka përbëre asnjë element i cili do të mohojë vërtetësinë e deklaratave të mëparshme. Për më tepër, ky version i ngjarjeve u vërtetua plotësisht nga dëshmitë e dëshmitarit Gj.L.

Veprimi i përshkruar më sipër i A.B. përbënte veprën penale të Kontrabandës së Migrantëve në kundërshtim me nenin 170 paragrafi 1 të KPRK ndërsa veprimi i caktuar për A.P. do të klasifikohet si vepër penale e ndihmes për kontrabandë të Migrantëve në kundërshtim me Nenin 170 Paragrafi 1 dhe Nenin 33 Paragrafi 2 i KPRK.

Veprat penale të kryera nga A.B. dhe A.P. janë kryer në vazhdimësi. Ata të përfituan nga situata e njëjtë dmth ekzistimi i kufizimeve të udhëtimit për qytetarët e Kosovës, e cila korrespondon me nenin 1 paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 3. Në të njëjtën kohë veprimet e tyre kriminale janë kryer në të njëjtën hapësirë, gjegjësisht në territorin e Kosovës dhe Serbisë që korrespondon me nenin 1 paragrafi 1 nën-paragrafët 1 dhe 4.

#### **Ne lidhje me M.B.**

M.B. ka pasur telefonata dhe kontakte personale ekstensive me B.N. Në disa raste ai gjithashtu kishte kontakte telefonike me A.B. Në disa raste ata ishin ndoshta duke folur për dokumente të ndryshme, por kjo nuk është vërtetuar se këto bisedime kanë rezultuar në ndonjë veprim të mëtejshëm. M.B. posedonte njohuri të dokumenteve në lidhje me origjinalitetin e tyre. Në disa raste ai e këshilloi B.N. sa i përket mundësisë së përdorimit të dokumenteve të caktuara për qëllime të udhëtimit.

Gjithashtu një tjetër person i paidentifikuar konsultoi M.B. në lidhje me mundësinë për të kalitur dokumente. Më 21 maj 2011 një person i paidentifikuar i ka dërguar një SMS M.B. duke e pyetur "Baci M. sa kushton për të fshirë një vulë nga pasaporta?", M.B. ishte gjithashtu në zotërim të një mjeti të veçantë - pincë për fiksime të fotografise në pasaporta ose dokumente të tjera me përdorimin e vrimë-hapëses metalike. Ai gjithashtu posedonte një numër të madh vrimë-hapësesh të tilla. Diku në mes të 1 maj 2011 dhe 10 qershor 2011 M.B. në një mënyrë të pazbuluar morri një pasaportë nr. xxx që ishte lëshuar fillimisht në emër të mbajtësit të ligjshëm, B.Th. nga Republika Federale e Jugosllavisë. Pasaporta është përdorur më parë nga B.Th. i cili ishte kontrabanduar jashtë nga B.N., siç përshkruhet më sipër, dhe iu dha B.N. B.N. ishte menduar që t'u kthente pasaportën familjes së B.Th., por ai nuk e ka bërë atë. Megjithatë, nuk kishte asnjë provë që pasaporta i është dhënë M. B. direkt dhe me vetëdije nga B.N. M.B. e ndryshoi këtë pasaportë duke zëvendësuar fotografinë e mbajtësit të ligjshëm me fotografi të F.F. Ai e bëri atë me përdorimin e pincës së sipërpërmendur dhe vrimë-hapëseve. Ai kishte qellim që pasaporta të përdorej për një kalim ilegal të kufirit. Nuk është provuar se M.B. ka vepruar për përfitim material. Pasaporta e ndryshuar më pas u transferua në një mënyrë të pazbuluar deri te N.B. N.B. ja dorëzoi këtë pasaportë F.F. që e ka përdorur atë gjatë një tentative të kalimit kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Fakti që M.B. kishte falsifikuar personalisht pasaportën e B.Th. u percaktua me anë të provave rrethore. Para së gjithash, siç është treguar nga të akuzuarit B.N., ai kishte një njohuri të duhur të dokumenteve. Pastaj, sipas

raportit të bastisjes të shtëpisë së tij ai ishte në posedim të vrimë-hapëseve dhe pincave (shih - Raportet e bastisjes se shtëpisë së të pandehurve dhe sende të konfiskuara, si dhe shënime mbi kontrollin gjatë rrjedhës së bastisjes se shtëpisë se të pandehurit, No 2011 - DKKO - nr 005, datë 11/06/2011). Paneli bëri një vlerësim bazuar në njohuri të zakonshme që ky lloj i pincës nuk ka gjasa që do të përdoret për qëllime tipike shtëpiake. Raporti Ekspertiza 2011-1584/2011-1672 datë 09/08/2011 dorëzuar nga Agjencia Ekzekutive - Laboratori i Mjekësisë Ligjore - Sektori i gjurmëve dhe Ekspertizave Dactiloskopike, vërtetoi se gjurmët e gjetura në një nga vrimë-hapëset e fotografise se ndryshuar mund të jenë lene nga mjeti i gjetur në shtëpinë e të akuzuarit. Paneli erdhi në përfundim se këto pjesë të dëshmive, kur analizohen së bashku, treguan se M.B. ishte me të vërtetë autori i falsifikimit.

Paneli erdhi në përfundimin se nga veprimet e mësipërme M.B. ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve publike në pajtim me nenin 332 paragrafin 3 të KPK-së. Nuk është vërtetuar se ai ka vepruar për përfitim material që përjashton një klasifikim ligjor të bazuar në nenin 138 paragrafi 2 KPK (kodi i vjetër), ose 170 paragrafi 2 i KPRK (kodi i ri).

Trupi gjykues ka arritur opinionin se pasaporta është një lloj i dokumentit publik pasi ajo është e lëshuar nga autoritetet publike në krahasim me dokumentet private, përkatësisht dokumentet me origjinë nga personat privatë. Neni 338 paragrafi 2 i Kodit të vjetër parashikon një gjobë ose me burgim deri në 3 vjet. Neni 398 paragrafi 2 i Kodit

të ri i cili i referohet falsifikimit të dokumentit publik parashikon një dënim më të rëndë dmth deri në 5 vjet burgim. Prandaj kodi i vjetër është aplikuar siç ishte më i favorshëm për M. B.

### **Ne lidhje me S.B.**

Në vitin 2011 S.B. organizoi një udhëtim me autobus për B.A. dhe një mashkull tjetër të paidentifikuar, shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk kanë qenë banorë të përhershëm apo shtetas të ndonjë shteti të zonës Shengen, nga territori i Kosovës në Serbi. Nga Serbia B.A. dhe mashkulli i paidentifikuar të dy pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit të vlefshme dhe duke perfituar nga aranzhimet e bëra për ta nga S.B. hynë në Zonën e Shengenit.

Me këtë veprim S.B. ka kryer veprat penale të kontrabandimit të migrantëve në kundërshtim me nenin 170 paragrafi 1 të KPRK;

Dikur më vonë, para 9 qershorit 2011 S.B. bëri po të njëjtat lloj të marrëveshjeve për një mashkull të paidentifikuar me emrin F. nga fshati Klodernice i cili ishte një shtetas i Republikës së Kosovës dhe nuk ishte një banor i përhershëm ose shtetas i ndonjë shteti Zonës Shengen. F. gjithashtu hyri në zonën Shengen pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit. Gjatë shqyrtimit kryesor nuk u zbulua çfarë lloj marrëveshje S.B. bëri për këta njerëz, por keto marrëveshje ishin të mjaftueshme për tu mundësuar atyre që të arrijnë qëllimin e tyre, dmth për të hyrë në një nga vendet e zonës së Shengenit. S.B. është paguar krejtësisht Euro 3600 për shërbimin që i kreu B.A. dhe



njeriut te paidentifikuar, i cili doli jashtë vendit me B.A., ndërsa nga F. ai ka fituar Euro 1600.

Me këtë veprim S.B. ka kryer të njëjtën vepër penale, siç tregohet më lart.

Faktet që lidhen me veprat penale të kryera nga S.B. janë percaktuar mbi bazën e deklaratës së dëshmitarit N.A. të dhënë në procedurën paraprake. Trupi gjykues e shpalli deklaratën e dhënë nga B.A. në lidhje me kohën e udhëtimit të tij jashtë vendit organizuar nga S.B. si të dyshimte. Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të dëshmive të dhëna nga N.A. dhe B.A. trupi gjykues erdhi në përfundim se vetëm versioni i besueshëm i ngjarjeve ishte ai i dhënë nga N.A. në rrjedhën e procedurës paraprake. Në atë kohë N.A. dha një indikacion mjaft të saktë të kohës kur B. vëllai i tij kishte shkuar jashtë vendit. Ai nuk ishte në gjendje të paraqiste ndonjë shpjegim bindës të ndryshimit të deklaratës së tij në këtë çështje. Ajo u shfaq mjaft e qartë për trupin gjykues që versionet e paraqitura nga të dy vëllezërit A. në gjykatë u trilluan pasi ata prezantuan kohën kritike ndryshe nga ajo që N.A. paraqiti në hetim. Siç është vënë tashmë në dukje nuk ka pasur dyshime për pranueshmërinë e identifikimit të S.B. nga N.A. si edhe për besueshmërinë e saj. Dëshmia e N.A. u konfirmua nga përmbajtja e një bisede telefonike të përgjuar në mes të një personi te paidentifikuar dhe S.B.: Në orën 19:26:02 me 29.03.2011, i pandehuri S.B. morri një SMS në numrin e tij të telefonit xxx nga një person i panjohur me një numër telefoni xxx, duke thënë: "Hej S., ata janë duke ikur tani a nuk me ke thënë për të gjetur adresën në mënyrë që ti dërgoni ata në Vjenë, e kam gjetur adresën, por ata nuk

janë duke i dërguar atje, në qoftë se ju flisni me ta tregojini atyre që ta dinë ose". Trupi gjykues nenkuptoi që mesazhi ka të bëjë me transportimin e emigrantëve jashtë vendit. Edhe pse nuk ka indikacione se ky mesazh ishte pjesë e ndonjë aktiviteti kriminal, ky fuqimisht tregon se S.B. kishte njohuritë e nevojshme dhe kontaktet për të dërguar emigrantët jashtë vendit.

Dy veprat e percaktuara për S.B. janë kryer për shkak se në dy raste ai shfrytëzoi ekzistencën e kufizimeve të udhëtimit për qytetarët e Kosovës dhe veprimet e tij kriminale janë kryer në territorin e Kosovës dhe Serbisë.

#### **Ne lidhje me të gjithë të pandehurit:**

Paneli erdhi në përfundim se nuk ka asnjë prove të vetme që mbështet pohimet se secili i akuzuar ka vepruar në një mënyrë që ka rrezikuar jetën dhe sigurinë e migrantëve.

Nuk ka dëshmi mbështetëse për pretendimin se ndonjë prej tyre ka vepruar në një grup të strukturuar të përbërë nga të paktën tre persona. Në veçanti analiza e komunikimit mes të pandehurve e kryer nga paneli i çoi në gjetjet që janë tashmë të paraqitura më lart. Kjo analizë nuk ka dhënë arsye për përfundimin se çdo veprim tjetër i tyre ishte i natyrës kriminal. Edhe pse (siç është treguar tashmë) bisedat e përgjuara dhe SMS mund të jenë të lidhura me kontrabandimin e migrantëve nuk kishte detaje të mëtejshme të zbuluara që do të lënë ndonjë dyshim për subjektin e këtyre bisedave. Nuk kishte asnjë provë nga ndonjë pjesë e përgjuar e komunikimit në mes të akuzuarve, me përjashtim të atyre të cituara tashmë së bashku me konstatimet e

percaktuara për secilin prej tyre, që rezultoi në veprime kriminale. Në veçanti, nuk ka ndonjë dëshmi që ndonje prej bisedave ose mesazhet SMS të ishin të lidhura me transportin e njerëzve jashtë shtetit, pa dokumente të udhëtimit që do të thotë edhe pa dokumentet e lëshuara nga autoritetet serbe. Prandaj, asnjë nga veprimet që i atribuohet të akuzuarit nuk mund të klasifikohet si një vepër e Krimit të Organizuar në bazë të nenit 274 të CKK ose në bazë të nenit 283 të KPRK. Ky përfundim ka rezultuar në lirimin e të gjithë të akuzuarve për akuzën e kryerjes së vepres penale të krimit të organizuar.

### **Percaktimi i denimit**

Kur përcaktohet dënimi për secilin nga të akuzuarit trupi gjykues ishte i detyruar të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, në pajtim me nenin 73 paragrafi (1) të KPK-së dhe në lidhje me M.B. në pajtim me nenin 64 paragrafin (1) të KPK-se.

Në lidhje me të gjithë të të akuzuarit trupi gjykues konsideroi si faktorë rëndues që Kontrabandimi i Migrantëve jashtë Kosovës duket të jetë një krim i kryer shpesh në ditët e sotme. Ajo ndikon seriozisht të gjitha përpjekjet zyrtare për liberalizimin e vizave. Prandaj dënimi për këtë lloj të krimit duhet të shërbejë si një parandalues i përgjithshëm për të gjithë kryesit potencial.

Në lidhje me të gjithë të akuzuarit, me përjashtim të A.P. dhe Z.Z., trupi gjykues konsideroi si një faktor rëndues shumen e të ardhurave të paligjshme të marra nga secili prej tyre për kontrabandimin e emigrantëve. Të ardhurat e

krijuara nga një person i kontrabanduar tejkaluan disa herë pagat mesatare në Kosovë.

Si faktorë lehtësues në lidhje me të gjithë të akuzuarit paneli gjykues mori parasysh se asnjë prej palëve të dëmtuara dmth asnjë nga personat e kontrabanduar nuk ishin të mashtruar apo të keqtrajtuar nga ndonjë prej të akuzuarve.

Në lidhje me ata të akuzuar që kanë kryer krime në vazhdim dmth N.B., B.B, A.B., S.B. dhe A.P. gjykata në pajtim me nenin 81 të KPRK-se shqiptoi një dënim. Trupi gjykues konsideroi si faktor rëndues numrin e veprave që përbëjnë krimin në vazhdimet që i atribuohet secilit prej tyre.

Kur u llogarit dënimi unik kundër A.B., trupi gjykues mori parasysh se veprat individuale me të cilat ai u dënua janë kryer në një mënyrë të ngjashme dhe në një interval të shkurtër kohor.

Fjalja kundër M.B. ishte llogaritur me konsideratë dhënë për faktin se falsifikimi që ai kishte kryer ishte një shumë i thjeshtë dhe nuk kërkonte ndonjë instrument të sofistikuar ose teknologji.

Gjatë shqiptimit të dënimeve kundër A.P. dhe Z.Z. trupi gjykues mbajti në mend se rolet e tyre në kryerjen e veprave penale ishin të vogla dhe të kufizuara në dhënien e ndihmës për kryerësin. Ata gjithashtu nuk kanë marrë dobi pasurore për vete, por vetëm për kryesin kryesor. Për më tepër, ata të dy dhanë deklaratatë të besueshme, kundër interesit të tyre, që i inkriminonin ata dhe autorët kryesor të krimit. Kjo është marrë nga trupi gjykues si një formë e shlyerjes. Këto rrethana janë aplikuar nga gjykata si faktorë lehtësues dënimi kundër A.P. dhe Z.Z.

Përveç kësaj në lidhje me S.B. trupi gjykues mbajti në mend si një rrethanë lehtësuese që akuzuari është kreu i familjes që përbëhet nga 7 fëmijë.

Të njëjtët faktorë lehtësues të cilat u morën parasysh në lidhje me, A.P. dhe Z.Z. dhe S.B. kontribuan për pezullimin e ekzekutimit të burgimit të shqiptuar kundër tyre. Trupi Gjykues arriti në përfundimin se ekzistojnë lidhjet sociale dhe ekonomike të cilat duhet të parandalojnë te akuzuarit ne fjale nga kryerja e një krimi në të ardhmen.

Ishte detyra e trupit gjykues për te kredituar periudhen kohore që te akuzuarit kaluan në paraburgim në kushtet e burgimit të cilat janë të vendosura respektivisht për secilin prej tyre.

Trupi gjykues urdhëroi konfiskimin e mjetit te përdorur për falsifikim që synon parandalimin e M. B. nga përdorimi i kesaj për qëllime kriminale në të ardhmen.

### **Shpenzimet**

Me që të gjithë të akuzuarit u shpallën fajtorë ata duhet pjesërisht të rimburojnë shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të kostos së përkthimit. Një vendim mbi vlerën e shumës pakete që secili prej tyre duhet të rimburojë në bazë të nenit 102 paragrafi 1 në lidhje me nenin 99 paragrafi 2, nën-paragrafi 6 të KPPK-se është lëshuar me konsideratë për numrin dhe seriozitetin e veprave për te cilat ata jane konstatuar fajtor.

GJYKATA THEMELORE PEJË

P.nr.38/12

Date 23 janar 2013

Procesmbajtese

Kryetar i Trupit Gjykues

---

Nexhmije Mezini

---

Dariusz Sielicki

Anetar i Trupit Gjykues

Anetar i Trupit Gjykues

---

Malcolm Simmons

---

Shaban Shala

Keshille ligjore:

Ankesa duhet të shpallet brenda 8 ditëve nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe do të dorëzohet në gjykatën e shkallës së parë, në bazë të nenit 400 paragrafi 1 të KPPK.

Personat e autorizuar mund të paraqesin një ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore te Pejës në Gjykatën e Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e dorezimit te kopjes se aktgjykimit, në bazë të nenit 398 paragrafi 1 të KPPK.